



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice*

Duke u bazuar në Rregulloren Nr. 2001/19 (Dega Ekzekutive e Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë), Rregulloren Nr. 2001/36 Mbi Shërbimin Civil të Kosovës, Urdhëresën Administrative Nr. 2003/2, Udhëzimin Administrativ Nr. MSHP/DASHC 2003/1 mbi procedurën e rekrutimit, Ministria e Drejtësisë shpallë këtë:

**K O N K U R S**

**IV: DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE LIGJORE**

**7. Pozita: Zyrtar Ligjor - 2 (dy vende pune)**

**Referenca: MD/DÇL/DBJN/18 - 08 - 07 - 2010**

**Paga: 251 € Koeficienti: 7**

**I përgjigjet: Udhëheqësit të Divizionit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar**

**Vendi: Prishtinë**

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Përgatitë përgjigjet për ndihmën juridike ndërkombëtare sipas procedurave të parapara me ligj dhe pas aprovimit nga shefi i Divizionit sigurohet që përgjigjet të jenë përkthyer dhe shpërndarë me kohë;
- Kryen hulumtime ligjore në çështjet e politikave ligjore që kanë të bëjnë me ligjin e zbatueshëm në Kosovë;
- Harton memorandume për rreshtime ndërkombëtare, memorandume për ekstradim, kërkesat për transferim të personave të dënuar; transferim të procedurave gjyqësore, letër-porosi, shërbim të dokumenteve, letër-thirrjeve, etj.
- Procedimin e kërkesave për vërtetimin e Autorizimeve të lëshuara nga Gjykatat e vendeve të rajonit, që kanë të bëjnë me transaksionet pronësore në Kosovë;
- Kryerjen e hulumtimeve dhe përgatitjen e analizave të çështjeve të politikave ligjore ndërkombëtare dhe të brendshme në lidhje me sistemin e Drejtësisë në Kosovë, veçanërisht në drejtim të ndihmës ligjore ndërkombëtare;
- Hartimin dhe rishikimin e legjislacionit dhe të udhëzimeve administrative mbi çështje që kanë të bëjnë me sistemin e drejtësisë;
- Kryen çdo detyrë tjetër që përfshihet në mandatin e Divizionit të bashkëpunim ndërkombëtar, në përputhje me ligjin e aplikueshëm në Kosovë.

**Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:**

- Diploma e Fakultetit Juridik;
- Të ketë përvojë pune profesionale të paktën dy (2) vjeçare,
- Aftësi për të hartuar dokumente ligjore të logjikshme, të qarta dhe të përpikta;
- Njohje e thellë e ligjit të zbatueshëm në Kosovë si dhe e të drejtës evropiane dhe ndërkombëtare;
- Aftësi të demonstruar në kryerjen e kërkimeve ligjore dhe përgatitjen e komunikatave dhe memorandumeve;
- Aftësia për të mbajtur qëndrim profesional në situata të vështira dhe ballafaqese, dhe nën trysni të mëdha kohore;
- Shprehi të forta analitike dhe kërkimore, përfshirë aftësinë për të vlerësuar dhe çmuar llojet e ndryshme të informacionit;

- Shprehi të shkëlqyera komunikimi me shkrim e me gojë;

**Periudha e kontratës:**

Punësimi bëhet me kontratë, kontrata e punës lidhet për periudhë kohore prej 1 viti, me 3 muaj punë provuese dhe me mundësi të vazhimit të kontratës.

**Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:** Ministria e Drejtësisë / Divizioni i Burimeve Njerëzore, Rruga « Ish-Ndërtesa e Rilindjes» kati i 7 - të, Zyra Nr. 723, Prishtinë, Kosovë;

**Për informata të hollësishme mund të kontaktoni zyrën e Divizionit të Burimeve Njerëzore në, tel: 038 / 213 860 ose 038 - 200 182 86), prej orës 08:00 - 16:00.**

**Konkursi ngel i hapur 15 ditë** nga dita e publikimit në njërën nga gazetat ditore, duke filluar nga data **18.08.2010** gjer më datën **01.09.2010** që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së konkursit.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrin brenda 4 ditësh, aplikacionet që arrin pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilin konkurrojnë.

Kandidatët të cilën hynë në përzgjedhje të ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga personeli.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë përmes telefonit dhe janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimet dhe trajnimet e kryera për verifikim para komisionit intervistues.